

**ECO TIRANA sh.a.**

Zyra e regjistruar: Tirana, Njesia Baskiake nr 2, Rr Murat Toptani, Gjergj Center, kati 7

Kapital Aksioner: 3.900.000 Lekë, paguar plotësisht

NIPT L61908027S

**VERBAL I ASAMBLESE no. 4**

Sot, më datë 30 Janar 2018, në orën 11, në Tiranë, pranë zyrave të Bashkisë Tiranë, në Sheshin Skënderbej Tiranë (Shoqëria), u mbledh totalisht, pas thirrjes së datës 05 Janar 2018, Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë. Është prezent aksioneri Bashkia Tiranë përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, Z. Erion Veliaj, dhe aksioneri AGSM Holding Albania Sh.a, përfaqësuar nga Z. Michelle Croce në cilësinë e Presidentit të Këshillit të Administrimit. Janë gjithashtu të pranishëm Administratori i Deleguar Z. Diego Testi dhe Z. Matia Bau Antarë i Këshillit të Mbikqyrjes.

Sipas Statutit të Shoqërisë, Kryetari i Bashkisë Tiranë Z. Erion Veliaj, përfaqësues i shumicës së Aksionerëve, merr presidencën dhe i kërkon Z. Kleant Novi, lindur në Memaliaj, më 14.09.1988, gjithashtu prezent, që pranon të veprojë si Sekretar.

Presidenti konstaton:

- Prezencën e të gjithë Akionerëve, në vecanti të Bashkisë Tiranë që përfaqëson 51% të kapitalit aksionerë të Shoqërisë dhe të AGSM Holding Albania Sh.a që përfaqëson 49% të kapitalit aksioner të Shoqërisë;
- Prezencën e administratorëve dhe këshilltarëve të mbikqyrjes të sipër përmendur;
- pëlqimin e shprehur nga aksionarët për të marrë vendime për çështjet në rendin e ditës, të cilët besojnë se janë mjaftueshëm të informuar;

Sipas paragrafit katër të nenit 138 të Ligjit Nr. 9901 datë 14 Prill 2008 Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqërit Tregtare" i ndryshuar, deklaron Asambleblen të mbledhur në mënyrë të vlefshme për të diskutuar dhe vendosur për sa vijon:

**RENDI I DITËS**

- 1) Marrja e aktit të dorëheqjes së Z. Venturi Fabio nga Këshilli i Mbikqyrjes dhe emërimin e antarit të ri dhe deteminimi i kompensimit përkatës;
- 2) Marrja e aktit të dorëheqjes së Z. Miglioranzi Andrea dhe Z. Cozzolotto Ennio nga funksioni i Administratorëve, emërimin e Administratorëve të rinjë dhe përcaktimin e kompensimit përkatës.

Presidenti deklaron të hapur diskutimin mbi pikën e parë të Rendit të Ditës:

**1. Marrja e aktit të dorëheqjes së Z. Fabio Venturi nga Këshilli i Mbikqyrjes dhe emërimin e antarit të ri dhe përcaktimin e kompensimit përkatës**

Për pikën e parë të rendit të ditës , merr fjalën Presidenti i Asmablesë i cili informon Asamblenë se Z. Fabio Venturi ka dhënë dorëheqjen në datë 12.12.2017 me efekt më 01.01.2018 nga antarë i Këshillit të Mbikqyrjes (Dokumentuar në shtojcën Nr. 1) dhe bëhet e nevojshme emërimi i antarit të ri.

Merr fjalën përfaqësuesi i Aksionerit AGSM Holdin Albania Sh.a Z. Michele Croce të cilit i përketë me Statut emërimi dhe propozon Z. Michele Croce, lindur në Verona më datë 16/02/1973, si Antarë i ri.

Asambleja në Unanimitet:

#### Vendos

- Emërimin në Këshillin e Mbikqyrjes të Z. Michele Croce, lindur në Verona më datë 16/02/1973, me nr pashaporte AS8486524, banues për shkak të detyrës në pranë Agsm Verona SpA , e vleshme deri në aprovimin e bilancit përkatës të vitit 2018;
- Të paguajë z. Michele Croce tarifën vjetore gjithëpërfshirëse prej € 4.200.00 duke filluar nga regjistrimi në Regjistrin e Bizneseve, në kuptim të drejtës së rimbursimit të shpenzimeve të bëra si rezultat i detyrës;
- Të ngarkojë Administratorin e Deleguar, ose personit të deleguar prej tij, të kujdeset për procedurat e nevojshme për rregjistrimin në Qëndrën Kombëtare të Biznesit dhe për cdo akt pasues.

Presidenti deklaron të mbyllur pikën e parë të Rendit të Ditës dhe kalon në pikën tjetër.

#### **2. Marrja e aktit të dorëheqjes së Z. Andrea Miglioranzi dhe Z. Ennio Cozzolotto nga funksioni i Administratorëve dhe emërimin e Administratorëve të rinjë dhe përcaktimin e kompensimit përkatës.**

Për pikën e dytë të rendit të ditës merr fjalën Presidenti i Asamblesë i cili informon Asamblenë se Z. Andrea Miglioranzi ka dhënë dorëheqjen nga funksioni i Presidentit të Këshillit të Administrimit në datë 13.12.2017, me afekt më datë 01.01.2018 (dokumentuar në shtojcën Nr. 2) dhe së Z. Ennio Cozzolotto ka dhënë dorëheqjen nga Antarë i Këshillit të Administrimit në datë 20.12.2017, me efekt më datë 01.01.2018 (dokumentuar në shtojcën Nr. 3) dhe bëhet e nevojshme emërimi i Presidentit të ri dhe Antarit të ri të Këshillit të Administrimit.

E merr fjalën përfaqësuesi i Aksionerit AGSM Holding Albania Sh.a Z. Michele Croce, të cilit i përket me Statut identifikimi i emërimin dhe propozon Z. Mirco Caliarì, lindur në Bussolengo, Itali, më datë 14/09/1975, si President i ri i Këshillit të Administrimit dhe Z. Andrea Benati lindur në Verona, Itali, më datë 15/11/1968, si Antarë i ri i Këshillit të Administrimit.

Asambleja në Unanimitet:

#### Vendos

- Emërimin si President i Këshillit të Administrimit Z. Mirco Caliarì, lindur në Bussolengo, Itali, më datë 14/09/1975, me numër pashaporte AU6177557, banues për shkak të detyrës pranë AGSM Verona SpA, e vlefshme deri në aprovimin e bilancit përkatës të vitit 2018;
- Të paguajë Z. Mirco Caliarì tarifën vjetore gjithëpërfshirëse prej € 10.440.00 duke filluar nga regjistrimi në Regjistrin e Bizneseve, në kuptim të drejtës së rimbursimit të shpenzimeve të bëra si rezultat i detyrës.;
- Emërimin si Antarë i Këshillit të Administrimit Z. Andrea Benati lindur në Verona, Itali, më datë 15/11/1968, me kartë identiteti nr. A4342902AA6, banues për shkak të detyrës pranë Eco Tirana Sh.a, e vlefshme deri në aprovimin e bilancit përkatës të vitit 2018;




- Të paguajë Z. Andrea Benati tarifën vjetore gjithpërfshirëse prej € 10.200.00 duke filluar nga regjistrimi në Regjistrin e Bizneseve, në kuptim të drejtës së rimbursimit të shpenzimeve të bëra si rezultat i detyrës;


- Të ngarkojë Administratorin e Deleguar, ose personit të deleguar prej tij, të kujdeset për procedurat e nevojshme për rregjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe për cdo akt pasues.


Askush nuk ka kërkuar fjalën, Presidenti deklaroi të mbyllur mbledhjen në orën 11:15.

Sekretar



President



MICHELE / CRACE  


## ECO TIRANA sh.a

Zyra e regjistruar: Tirana, Njesia Bashkiake nr 2, Rr Murat Toptani, Gjergij Center, kati 7

Kapital Aksioner: 3.900.000 Lekë, paguar plotësisht

NIPT L61908027S

### VERBAL I ASAMBLESE nr. 5

Sot, më datë 30 Janar 2018, në orën 11:15, në Tiranë, pranë zyrave të Bashkisë Tiranë në Sheshin Skënderbej Tiranë (Shoqëria), u mbledh totalisht, pas thirrjes së datës 05 Janar 2018, Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë. Është prezent aksioneri Bashkia Tiranë përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, Z. Erion Veliaj, dhe aksioneri AGSM Holding Albania Sh.a, përfaqësuar nga Z. Michelle Croce në cilësinë e Presidentit të Këshillit të Administrimit. Janë gjithashtu të pranishëm Administratori i Deleguar Z. Diego Testi dhe Z. Matia Bau Antarë i Këshillit të Mbikqyrjes.

Sipas Statutit të Shoqërisë, Kryetari i Bashkisë Tiranë Z. Erion Veliaj, përfaqësues i shumicës së Aksionerëve, merr presidencën dhe i kërkon Z. Kleant Novi, lindur në Memaliaj, më 14.09.1988, gjithashtu prezent, që pranon të veprojë si Sekretar.

Presidenti konstaton:

- Prezencën e të gjithë Aksionerëve, në vecanti të Bashkisë Tiranë që përfaqëson 51% të kapitalit aksioner të Shoqërisë dhe të AGSM Holding Albania Sh.a që përfaqëson 49% të kapitalit aksioner të Shoqërisë;
- Prezencën e administratorëve dhe këshilltarëve të mbikqyrjes të sipër përmendur;
- Pëlqimin e shprehur nga aksionarët për të marrë vendime për çështjet në rendin e ditës, të cilët besojnë se janë mjaftueshëm të informuar;

Sipas paragrafit katër të nenit 138 të Ligjit Nr. 9901 datë 14 Prill 2008 Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqërit Tregtare" i ndryshuar, deklaroi Asamblen të mbledhur në mënyrë të vlefshme për të diskutuar dhe vendosur për sa vijon:

### RENDI I DITËS

- 1) Përbushja e detyrimeve në zbatim të Ligjit nr. 8885 datë 22.04.2002 mbi projektimin e programit ekonomik financiar për vitin 2018;
- 2) Aprovimin e Rregullores së shoqërisë "Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit";

- 3) Aprovimin e Rregullore së shoqërisë “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja”;
- 4) Aprovimin e Rregullore së shoqërisë “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”;
- 5) Autorizimin e Administratorin të Deleguar për të plotësuar formalitetet e nevojshme për kompletimin e procedurave për marrjen e dy linjave të kredisë dhënë kompanisë nga Intesa Sanpaolo Bank;
- 6) Komunikime të Administratorit të Deleguar;
- 7) të ndryshme dhe të mundshme

Presidenti deklaron të hapur diskutimin mbi pikën e parë të Rendit të Ditës:

#### **1. Përmbyshja e detyrimeve në zbatim të Ligjit nr. 8885 datë 22.04.2002**

Për pikën e parë të rendit të ditës, Presidenti i jep fjalën Administratorit të Deleguar Z. Diego Testi i cili informon Asamblenë se Këshilli i Mbikëqyrjes në mbledhjen e saj të 17 Janarit të kaluar, ka vendosur të shtyjë miratimin e dokumentit në pritje të përcaktimit të planit të ri trivjeçar të biznesit i cili do të duhet të sigurojë zgjerimin e shërbimeve sipas bisedimeve që po ndodhin midis Aksionerëve. Rrjedhimisht, Asambleja e Aksionerëve kërkohet të mos vazhdojë me miratimin e tabelës dhe shtyrjen e kësaj pike në miratimin e planit të ardhshëm trivjeçar të biznesit.

Presidenti, pasi dëgjoi Ortakët, shtyn këtë pikë, e deklaron të mbyllur dhe kalon në pikën tjetër;

#### **2. Aprovimin e Rregullore së shoqërisë “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit” në bazë të Ligjit 60/2016;**

Për pikën e dytë të rendit të ditës, e merr fjalën Presidenti i Asamblesë i cili informon Asamblenë se Ligi 60/2016 kërkon adoptimin e Rregullore së Shoqërisë, në diskutim të kësaj pike (shtojca nr. 1) dhe komunikon se teksti, hartuar nga Zyra Ligjore e Shoqërisë, është aprovuar në mbledhjen e Këshillit të Mbikëqyrjes të 14 Nëntorit 2017.

Administratori i Deleguar komunikon se, në aplikimi të kësaj normative për subjektet me mbi 100 punonjës, sic është Eco Tirana Sh.a, është emëruar Përgjegjësi i Shoqërisë për procedurat e hetimit mbi senjalimin e akteve të dyshuara korruptive dhe i është transmetuar ILDKPKI brenda datës 15 Janar-it të kaluar, komunikimi i planifikuar mbi veprimtarinë e kryer në këtë fushë.

Aksionerët deklarojnë rëndësinë e paanshmërisë dhe transparencës së procedurave për caktimin e furnizimeve të miratuara nga Shoqëria edhe në bazë të Kodit të Etikës të miratuar në mbledhjen e



Asamblesë të datës 25 gusht 2016 dhe, rrjedhimisht, nevojës që çdo senjalim të akteve të dyshuar korruptive të vlerësohet në mënyrë të përshtatshme.

Presidenti , duke mos pasur më kërkesa për sqarim, kalon në votimin e pikës.

Asambleja në unanimitet:

## VENDOS

- Miratimin e Rregullore së Shoqërisë (Shtojca nr.1) “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit” në bazë të Ligjit 60/2016.

Presidenti deklaron të mbyllur pikën e tretë të Rendit të ditës dhe kalon në diskutimin e pikës tjetër.

### **3. Aprovimin e Rregullore së shoqërisë “Për hetimit administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja” në zbatim të ligji 60/2016;**

Për pikën e tretë të rendit të ditës e merr fjalën Presidenti i Asamblesë i cili informon të pranishmit se normativa kërkon që Shoqëria të adaptoj një Rregullore specifike në mbrojtje të personave që sinjalizojnë akte korruptive, në dëm të të cilëve mund të meren masa për hakmarrje.

Rrjedhimisht, bëhet e nevojshme adaptimi i Rregullore (Shtojca 2) i cili kompletton atë cfarë u miratua në pikën paraardhëse.

Administratori i Deleguar informon se drafti i Rregullore, hartuar nga Zyra Ligjore e Shoqërisë, është miratuar në datë 17.01.2017 nga Këshilli i Mbikëqyrjes.

Presidenti, duke mos pasur më kërkesa për sqarim, kalon në votimin e pikës.

Asambleja në unanimitet:

## VENDOS

- Miratimi i Rregullore të Shoqërisë (Shtojca N ° 2) për mbrojtjen dhe aktet e mundshme të hakmarrjes te sinjalizuesit pas raportit mbi akteve të korrupsionit sipas Ligjit 60/2016.

Kryetari deklaron te mbyllur piken e tretë në Rendin e Ditës dhe vazhdon në diskutimin e rradhes.

### **4. Miratimi i rregullore “Për mbrojtjen, trajtimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale ne baze te Ligjit 9887/2008.**

Në pikën e katërt të rendit të ditës, Presidenti i jep fjalën Administratorit te Deleguar Z. Diego Testi i cili informon se në selinë operationale të Rr Don Bosko, për të monitoruar zonën dhe për të kontrolluar aksesin e njerëzve të panjohur, është instaluar një sistem me kamera survejimi i lidhur me një monitor

në dispozicion të rojes. Rrjedhimisht, është e nevojshme të kemi një rregullore specifike për mbrojtjen e të dhënave personale. Teksti i propozuar për votimin e Asamblesë, është realizuar nga Zyra Ligjore e Shoqërisë, dhe u miratua nga Këshilli i Mbikëqyrjes më 17 janar 2018.

Presidenti, pasi nuk u kërkuan sqarime, kaloi në votimi e pikës.

Asambleja ne unanimitet:

## VENDOS

- Miratimi i Rregullores së Shoqërisë (Shtojca Nr. 3) në lidhje me mbrojtjen, trajtimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale sipas Ligjit 9887/2008.

Presidenti deklaroi të mbyllur pikën e katërt të rendit të ditës dhe kalon në diskutimin e pikës tjetër.

### **5. Autorizimi i Administratorit të Deleguar për ekzekutimin e formaliteteve të nevojshme për kompletimin e dy linjave të kredisë dhënë Shoqërisë nga Intesa Sanpaolo Bank**

Në pikën e pestë të Rendit të Ditës, Administratori i Deleguar mori fjalën dhe rikujton miratimin e Asamblesë së Ortakëve me të cilën ai ishte i autorizuar të fillonte procedurat në Institucionin Bankar të Intesa Sanpaolo Bank për marrjen e linjave kreditore, informon se dy linjat e kredisë janë dhënë dhe Këshilli Mbikëqyrës në seancën e fundit të datës 17 janarit ka autorizuar Administratorin për të nënshkruar dokumentet që lidhen me praktikën. Administratori i Deleguar vazhdon duke informuar se një kërkesë i është dërguar Anëtarit Agsm Holding Albania, me të cilin kërkohet një "garanci korporate", kërkuar nga Intesa Sanpaolo Bank, për kompletimin e linjës së kredisë prej 10,000,000 Lekë për overdraft në llogarinë rrjedhëse. Merr fjalën Z. Michele Croce, duke përfaqësuar Agsm Holding Albania, i cili njofton se sapo ka marrë detyrën në Këshillin e Administrimit të shoqërisë, e cila do të vendosë në seancën e ardhshme të planifikuar për 18 shkurt "garancinë korporative" siç kërkohet.

Asambleja merr parasysh komunikimin dhe, duke mos patur çfarë të miratoi për këtë çështje, Presidenti deklaroi të mbyllur këtë pikë dhe vazhdon diskutimin e pikës tjetër.

### **6. Komunikim nga Administratori i Deleguar**

Presidenti i jep fjalën Administratorit të Deleguar i cili informon Ortakët se në datën 12 Janarin e kaluar është marr në protokollin e Shoqërisë dokumenti (Shtojca Nr.4) me anë të së cilit Shoqëria Meg Albania Sh.p.k. ka komunikuar synimin e saj për të shitur 49% të aksioneve në kapitalin aksionar të mbajtur në Eco Recycling Sh.p.k. me çmimin prej 8.262.000 Lekë. Meg Albania Sh.p.k pyetë, duke u bazuar në Nenit 10 të Statutit të Shoqërisë Eco Recycling Sh.p.k, Eco Tirana Sh.a të shprehet për përdorimin e mundshëm të "të drejtës së parablerjes". Administratori vazhdon duke informuar se Shoqëria që do të



blejë aksionet e zotëruara nga Meg Albania Sh.p.k në Eco Recycling Sh.p.k. është Integrated Energy BV SPV Sh.p.k. i cili është administruesi i ri i deponisë së Sharrës pas vendimit në një procedurë tenderimi të iniciuar nga Ministria e Mjedisit në Shqipëri. Gjithashtu, më 12 janar 2018, Administratori i Eco Recycling Sh.p.k, Z. Vladimir Fezga, njoftoi se impianti i seleksionimit është ndalur pasi Shoqëria Integreted Energy BV SPV Sh.p.k po kryen punime brenda deponisë së Sharrës, e cila pengon hyrjen në impiant (Shtojca N ° 5).

E merr fjalën Z. Michele Croce si përfaqësues i Aksionerit Agsm Holdin Albania për të informuar Asamblenë se një normativ italiane ( Ligji Madia) e cila ka vendosur kufizime shoqërive publike të cilat për të operuar jashtë territorit të tyre është e nevojshme të marrin një autorizim specifik nga Qeveria Italiane. Presidenti Croce vazhdon të informoj se Agsm Verona Spa e ka bërë tashmë këtë kërkesë e cila aktualisht është duke u shqyrtuar nga Presidenca e Këshillit të Ministrave. Në këtë situatë aksioneri Agsm Holdin Albania kërkon që të ruhet struktura aktuale e shoqërisë në Eco Recycling dhe kërkon që Bashkia Tiranë të ndërhyjë tek blerësi i kuotave të Meg Albania në Eco Recycling në mënyrë që e njëjta të mbajë ofertën e saj të blerjes të vlefshme, por të shtyjë efektivitetin e saj pas përfundimit të praktikës së cituar. Aksioneri Bashkia Tiranë komunikon disponueshmërinë e saj për të kontaktuar blerësin për të bërë këtë propozim.

Duke mos pasur asgjë për të vendosur Presidenti i jep fjalën Administratorit të Deleguar i cili rikujtoi se akti i konstitimit të Shoqërisë ka identifikuar te "Deloitte Audit Albania" Sh.p, k, Audituesin e Shoqërisë dhe se ky emërim skadoi këtë vitë pa qnën i mundur rinovimi me specifikim të Asamblesë së Aksionerëve, parashikuar në Statut, që i përket ky emërim. Në pritje të formalizimit të kësaj pozite, Administratori i Deleguar, pasi ka dëgjuar Presidentin e Këshillit Mbikëqyrës, ka autorizuar "Deloitte Audit Albania sh.p.k"për të vazhduar me aktet e detyrueshme (si inventari i magazines) dhe për të kërkuar një ofertë ekonomike në përputhje me normat e përdorura nga Auditorë të pavarur të ngjashëm. Presidenti gjithashtu rikujton se kjo Shoqëri Auditimi kryen detyrat e tij si Auditues në emër të Bashkisë së Tiranës, aksioner i shumicës së Eco Tirana Sh.a. dhe se është e përshtatshme që Audituesi i Shoqërisë të jetë i njëjtë me atë të Bashkisë Aksioner shumice. Administratori i Deleguar propozon që emërimi mund të bëhet për vitin 2017 dhe 2018 në mënyrë të tillë që Audituesi të ketë të njëjtin afat si Organi Administrativë i Shoqërisë.

Asambleja ne unanimitet:

#### **VENDOS:**

- Emërimin për vitin 2017 dhe 2018 të Shoqërisë "Deloitte Audit Albania Sh.p.k në Auditues të Shoqërisë me skadimin e emërimit së bashku me afatin e fundit të Organit Administrative.




- Kompensimin për Audituesin për peridhën e treguar është vendosur në 8.500,00 € + TVSH në vitë përfshirë vlerësimin e bilancit të Eco Recycling Sh.p.k i cili duhet të konsolidohet me atë të Eco Tirana Sh.a

Presidenti deklaron të mbyllur pikën dhe kalon në diskutimin e pikës tjetër.


7. **të ndryshme dhe të mundshme**

Duke mos kërkuar njëri fjalën, Presidenti deklaron të mbyllur mbledhjen në orën 12:15.

Sekretari



Presidenti



MICHELE CROCE